



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Nazim Gafurri I (Miladin Popovic)
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI Nr: 1

VENDIMI NR.: KPCC/D/2/2007
DATA E VENDIMIT: 24/08/2007

URDHËR

(1) Për secilën nga 487 (katërqind e tetëdhjetë e shtatë) kërkesat e identifikuara në pjesët A, B dhe C të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

(a) Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka dëshmuar pronësinë mbi pronën e kërkuar, apo pjesë të tilla siç janë specifikuar në vendimin përkatës individual; dhe

urdhëron që

(b) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;

(c) Pala përgjegjëse dhe çdo person tjetër i cili e ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij urdhri; dhe

(d) Nëse pala përgjegjëse dhe çdo person tjetër i cili e ka uzurpuar pronën dështon të përmbush urdhrin për lirim brenda kohës së dhënë, ata të dëbohen nga prona.

(2) Për secilën nga 138 kërkesat e identifikuara në pjesën D të listës së bashkangjitur, Komisioni si plotësim vendos që kërkesat të refuzohen përkitazi me kërkesën e paraqitësve të kërkesave në lidhje me kompensim për dëmet fizike në pronën e kërkuar ose, respektivisht, për shfrytëzim të paautorizuar të saj.

(3) Në kërkesat në të cilat ka më shumë se një pronar, vendimi i mësipërm nuk ndikon në të drejtat e ndonjë bashkëpronari përkatës.

ARSYET PËR VENDIMIN

1. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për urdhër nga Komisioni për riposeditim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e patundshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; apo
- (b) të drejtën e shfrytëzimit mbi pronën e patundshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me të apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.)

2. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Komisioni duhet t'a zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia, të japë urdhër për riposeditim në dobi të paraqitësit të kërkesës. (Shiko nennin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit 3 të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5.)

3. Komisioni ka mbajtur seancën e tij të dytë me 21-24 Gusht 2007 në Prishtinë. Gjithsej 1,179 kërkesa i janë paraqitur Komisionit në seancën e tij të dytë nga Sekretaria Ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës (përkatësisht "Sekretaria Ekzekutive" dhe "KPA"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informatat tjera relevante.

4. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ia ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin dhe çështjet ligjore dhe të dokumentuara që kanë rrjedhur nga kërkesat. Me kërkesën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime plotësuese, sipas nevojës.

A. Kërkesat e pronësisë

5. Bazuar në shqyrtimet e kërkesave dhe dokumentacionin mbështetës, dhe në informatat e ofruara dhe verifikimet e kryera nga Sekretaria Ekzekutive, gjithsej 692 kërkesa i janë kthyer Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni, për rishikim dhe verifikim plotësues, apo ishin tërhequr nga Sekretaria Ekzekutive. Këto kërkesa, të cilat janë të regjistruara në pjesën E të listës së bashkangjitur, do të shqyrtohen në kohën e duhur nga Komisioni. Ashtu që vendimi aktual i adresohet 487 kërkesave të mbetura të cilat janë të regjistruara në pjesët A, B dhe C të listës së bashkangjitur. Në të gjitha këto kërkesa paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës mbi pronësinë, dhe që të gjitha nga ato ndërlidhen me pronat bujqësore, përfshirë tokën bujqësore, kullosat dhe pyjet.

6. Komisioni vë në pah se të gjitha kërkesat e regjistruara në pjesët A, B dhe C të listës së bashkangjitur janë të pakontestuar në kuptimin se në kohën kur janë notifikuar pronat e kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person, bile edhe nëse ka pasur ndonjë dëshmi të tillë, asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës 30 ditëshe të paraparë me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur se Sekretaria Ekzekutive kishte bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar

pronat e kërkuara, personat të cilët aktualisht mund të jenë në uzurpim të pronave, dhe të çdo personi tjetër i cili mund të ketë interes ligjor mbi pronat e tilla, siç parashihet me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 20006/50. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të konsiderohen si të pakontestuar.

7. Në 423 kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, Komisioni vë në pah se paraqitësit e kërkesave apo bartësit e të drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në mbështetje të kërkesave të tyre mbi pronësinë kanë paraqitur dokumente të llojeve të ndryshme, përfshirë fletët poseduese, kontratat mbi shitblerjen, kontratat mbi dhurimin, kontratat mbi ndarjen e pronës, dhe vendimet e gjykatës mbi njohjen e pronësisë. Komisioni është i kënaqur se këto dokumente në të vërtetë përbëjnë dëshmi mbi pronësinë. Shumë paraqitës të kërkesave gjithashtu kanë paraqitur dokumente mbështetëse shtesë, përfshirë vendimet mbi tatimin, deklarata të dëshmitarëve, kopjet e planit dhe vendimet e kadastrës. Të gjitha këto dokumente janë vërtetuar nga Sekretaria Ekzekutive të jenë valide.

8. Në 64 kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkangjitur, Komisioni vë në pah se paraqitësit e kërkesave apo bartësit e të drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në mbështetje të kërkesave të tyre mbi pronësinë kanë paraqitur vendimet mbi trashëgiminë. Komisioni është i kënaqur se këto dokumente në të vërtetë përbëjnë dëshmi mbi pronësinë. Të gjitha këto dokumente janë vërtetuar nga Sekretaria Ekzekutive si valide.

9. Dokumentet e ndryshme, në të cilat paraqitësit e kërkesave mbështesin kërkesat e tyre dhe të cilat përmenden në paragrafët 7 dhe 8 të mësipërme, janë të regjistruara në pjesën F të listës së bashkangjitur.

10. Në të dy grupet e kërkesave të ndërlidhura të identifikuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, p.sh. Kërkesat Nr. 15474&15434 dhe Kërkesat Nr. 15456&15473, Komisioni konstaton se, derisa secila nga të dy grupet e kërkesave ndërlidhen me pronat e njëjta, Paraqitësit e kërkesave kërkojnë vetëm pjesët e tyre përkatëse të pronave ashtu që kërkesat nuk kanë asgjë të përbashkët. Komisioni është i kënaqur se secili Paraqitës i kërkesave ka dëshmuar pronësinë mbi pjesët përkatëse të pronave të kërkuara, në ato pjesë të cilat janë specifikuar në vendimet përkatëse individuale.

11. Duke pasur parasysh të mësipërmen, Komisioni është i bindur, bazuar në dëshminë dhe informatat që i posedon, se:

- (a) paraqitësi i kërkesës në secilin rast ka treguar, se paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, e ka pasur të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo një pjesë e tillë nga kjo sikurse është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) secila kërkesë është e pakontestuar në atë se asnjë person nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës;
- (c) paraqitësi i kërkesës në secilin rast tani nuk mund ta ushtrojë të drejtën e tij apo saj të pronësisë; dhe

- (d) paraqitësi i kërkesës në secilin rast ka treguar se kërkesa e tij apo e saj përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë si pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.


B. Kërkesat për kompensim

12. Në 138 kërkesat e regjistruara në pjesën D të listës së bashkangjitur, përpos pronësisë, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë kompensimin për dëmet fizike ndaj pronës së kërkuar ose, respektivisht, për shfrytëzim të paautorizuar të saj. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/50, Komisioni nuk ka jurisdiksion për këso lloj kërkesash. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të refuzohen.

C. Vërejtje përmbledhëse

13. Nga ajo që u cek më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e regjistruara në pjesët A, B dhe C të listës së bashkangjitur janë të suksesshme dhe t'u jepet urdhri për secilën kërkesë siç është cekur më lart.

14. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative nr. 2007/5, lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor, duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuar në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 parasheh që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqes ankesë, përmes Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Pronën, ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim themelor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në fakte të gabuara apo vlerësim të gabuar të fakteve.

* Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA00434	KPA07259	KPA07623	KPA10208	KPA14289	KPA15686
KPA06050	KPA07265	KPA07627	KPA10209	KPA14315	KPA15687
KPA06176	KPA07271	KPA07630	KPA11353	KPA14318	KPA15708
KPA06291	KPA07274	KPA07635	KPA13050	KPA14341	KPA15716
KPA06308	KPA07277	KPA07637	KPA13134	KPA14343	KPA15717
KPA06569	KPA07280	KPA07641	KPA13135	KPA14394	KPA15718
KPA06577	KPA07285	KPA07653	KPA13193	KPA14436	KPA15722
KPA06578	KPA07286	KPA07737	KPA13237	KPA14438	KPA15723
KPA06579	KPA07287	KPA07747	KPA13245	KPA14468	KPA15724
KPA06621	KPA07291	KPA07750	KPA13278	KPA14471	KPA15866
KPA06657	KPA07298	KPA07752	KPA13280	KPA14485	KPA15867
KPA06661	KPA07299	KPA07756	KPA13283	KPA14488	KPA15918
KPA06667	KPA07301	KPA07757	KPA13293	KPA14526	KPA16209
KPA06675	KPA07305	KPA07758	KPA13329	KPA14704	KPA16243
KPA07006	KPA07308	KPA07759	KPA13463	KPA14705	KPA16495
KPA07011	KPA07311	KPA07761	KPA13770	KPA14707	KPA16521
KPA07014	KPA07318	KPA07871	KPA13771	KPA14809	KPA17719
KPA07015	KPA07324	KPA07875	KPA13773	KPA14813	KPA17938
KPA07018	KPA07326	KPA07938	KPA13774	KPA14827	KPA18016
KPA07019	KPA07336	KPA08216	KPA13775	KPA15018	KPA18020
KPA07020	KPA07421	KPA08220	KPA13776	KPA15019	KPA18034
KPA07021	KPA07515	KPA08221	KPA13777	KPA15023	KPA18040
KPA07023	KPA07520	KPA08222	KPA13778	KPA15063	KPA18160
KPA07024	KPA07522	KPA08348	KPA13779	KPA15067	KPA18348
KPA07025	KPA07523	KPA08370	KPA13780	KPA15068	KPA18349
KPA07026	KPA07526	KPA08372	KPA13781	KPA15071	KPA18350
KPA07027	KPA07534	KPA08432	KPA13818	KPA15084	KPA18351
KPA07029	KPA07537	KPA08614	KPA13819	KPA15206	KPA18352
KPA07030	KPA07539	KPA08748	KPA13820	KPA15209	KPA18353
KPA07031	KPA07542	KPA08751	KPA13830	KPA15210	KPA18357
KPA07034	KPA07566	KPA08767	KPA13832	KPA15211	KPA18358
KPA07035	KPA07568	KPA08776	KPA13888	KPA15357	KPA18360
KPA07040	KPA07590	KPA08780	KPA13889	KPA15646	KPA18438
KPA07041	KPA07597	KPA08851	KPA13892	KPA15669	KPA18439
KPA07042	KPA07599	KPA08922	KPA13933	KPA15670	KPA18440
KPA07045	KPA07603	KPA08953	KPA13970	KPA15671	KPA18442
KPA07048	KPA07606	KPA10122	KPA14041	KPA15672	KPA18444
KPA07216	KPA07617	KPA10156	KPA14059	KPA15673	KPA18445
KPA07252	KPA07620	KPA10157	KPA14061	KPA15678	KPA18446
KPA07257	KPA07621	KPA10160	KPA14255	KPA15685	KPA18447

KPA18449	KPA24093	KPA08556	KPA10082	KPA06281	
KPA18450	KPA24095	KPA18131	KPA10128	KPA06285	
KPA18452	KPA24096	KPA19058	KPA10129	KPA06625	
KPA18453	KPA24098	KPA23965	KPA10161	KPA15022	
KPA18455	KPA24099	KPA00435	KPA10183	KPA15363	
KPA19015	KPA24105	KPA06275	KPA10202	KPA15645	
KPA19033	KPA24107	KPA06310	KPA10205	KPA25589	
KPA19036	KPA24117	KPA06321	KPA10206	KPA26013	
KPA19037	KPA24125	KPA06538	KPA10207	KPA10065	
KPA19040	KPA24135	KPA06571	KPA10237	KPA10066	
KPA19042	KPA24380	KPA06627	KPA11026	KPA15689	
KPA19044	KPA24410	KPA06676	KPA11348		
KPA19069	KPA24414	KPA07003	KPA13133		
KPA19091	KPA24619	KPA07008	KPA13285		
KPA19115	KPA24634	KPA07009	KPA13497		
KPA19173	KPA24735	KPA07012	KPA13652		
KPA19175	KPA24736	KPA07017	KPA13654		
KPA19176	KPA24737	KPA07032	KPA14008		
KPA19178	KPA24738	KPA07044	KPA14251		
KPA19179	KPA25007	KPA07046	KPA14439		
KPA19181	KPA25008	KPA07058	KPA14839		
KPA19185	KPA25106	KPA07251	KPA15100		
KPA19189	KPA26011	KPA07266	KPA15125		
KPA19295	KPA27011	KPA07272	KPA15213		
KPA20021	KPA27514	KPA07304	KPA15725		
KPA20068	KPA27647	KPA07309	KPA16293		
KPA20117	KPA27649	KPA07325	KPA18456		
KPA20130	KPA27651	KPA07532	KPA19089		
KPA20192	KPA27753	KPA07535	KPA19090		
KPA21031	KPA27761	KPA08218	KPA19170		
KPA22038	KPA28120	KPA08219	KPA20016		
KPA22039	KPA28122	KPA08364	KPA20018		
KPA22040	KPA28155	KPA08421	KPA20191		
KPA14176	KPA28178	KPA08422	KPA23572		
KPA22389	KPA28434	KPA08426	KPA23840		
KPA22390	KPA28474	KPA08429	KPA24629		
KPA22391	KPA31111	KPA08549	KPA27012		
KPA22392	KPA31518	KPA08564	KPA27021		
KPA22393	KPA31521	KPA08606	KPA27648		
KPA22394	KPA31527	KPA08697	KPA27650		
KPA23506	KPA31687	KPA08835	KPA27652		
KPA24006	KPA06398	KPA10067	KPA27656		
KPA24018	KPA07504	KPA10073	KPA27743		

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA06017	KPA15456	KPA15456 &	
KPA06028	KPA15473	KPA15473	
KPA06047	KPA15474	KPA15474 &	
KPA07079	KPA15690	KPA15434	
KPA07080	KPA15697		
KPA07081	KPA15699		
KPA07082	KPA15702		
KPA07087	KPA15703		
KPA07314	KPA16249		
KPA07320	KPA16250		
KPA07562	KPA16351		
KPA07921	KPA16450		
KPA07931	KPA21038		
KPA08179	KPA21042		
KPA08184	KPA21122		
KPA08987	KPA21123		
KPA11204	KPA21125		
KPA13433	KPA22340		
KPA13520	KPA27204		
KPA13521	KPA28331		
KPA13522	KPA28557		
KPA13523	KPA28561		
KPA13766	KPA28562		
KPA13768	KPA28567		
KPA13769			
KPA13937			
KPA13938			
KPA13939			
KPA13940			
KPA13942			
KPA14065			
KPA14069			
KPA14071			
KPA14216			
KPA14295			
KPA14305			
KPA14307			
KPA14308			
KPA15238			
KPA15434			